



European Asylum Support Office

Rivendosja e kërkuesve të mbrojtjes ndërkombëtare

Broshurë informative



SQ

SUPPORT IS OUR MISSION

“Çfarë është rivendosja?”

Rivendosja është transferimi i azilkërkuesve që kanë nevojë të qartë për mbrojtje ndërkombëtare nga një shtet anëtar i BE-së në një shtet tjetër evropian. Kërkesa e azilit do të ekzaminohet vetëm pas rivendosjes së azilkërkuesit. Rivendosja është e mundur vetëm nga Italia dhe Greqia.



Personeli i EASO me anëtarët e grupit të parë të njerëzve që janë rivendosur nga Italia.

“A zbatohet kjo në rastin tim?”

Ju jeni i/e kualifikuar për rivendosje në qoftë se ju keni nevojë të qartë për mbrojtje ndërkombëtare dhe jeni shtetas ose rezident pa shtetësi i disa shteteve të përcaktuara. Aktualisht, shtetasit e Sirisë, Eritresë, Irakut, Republikës së Afrikës Qendrore, Bahreinit, Jemenit dhe Suazilendit janë të kualifikuar për këtë.

Përveç kësaj, për të përfituar nga rivendosja:

- ju duhet të keni paraqitur kërkesën e parë për mbrojtje ndërkombëtare në Greqi ose Itali;
- ju duhet t’i nënshtroheni procesit të identifikimit, regjistrimit dhe marrjes së shenjave të gishtave, i cili kryhet nga autoritetet italiane dhe greke;
- ju duhet të provoni që keni arritur në Itali ose Greqi pas datës 25 mars 2015.



“A do të më marrin shenjat e gishtave?”

Të gjithë azilkërkuesve do t’u merren shenjat e gishtave. Pavarësisht nëse ju kërkoni mbrojtje ndërkombëtare apo jo, nëse ju jeni 14 vjeç ose më shumë, shenjat e gishtave do t’ju merren dhe ruhen në bankën evropiane të të dhënave “Eurodac”. Ju duhet të bashkëpunoni me këtë procedurë, sepse ligji parashikon që marrja e shenjave të gishtave është e detyrueshme. Ju nuk do të jeni i/e kualifikuar për rivendosje në qoftë se nuk ju janë marrë shenjat e gishtave.



“Unë kam nevoja të veçanta. A do të kem prioritet?”

Po, personat e cenueshëm kanë prioritet në procesin e rivendosjes dhe interesi më i mirë i fëmijës do të jetë argumenti kryesor i autoriteteve.

Personat e cenueshëm përfshijnë sidomos: të miturit, të miturit e shoqëruar, personat me paaftësi, njerëzit e moshuar, gratë shtatzënë, prindërit e vetëm me fëmijë të mitur, viktimat e trafikut të qenieve njerëzore, njerëzit me sëmundje të rënda, njerëzit me çrregullime mendore dhe njerëzit që kanë pësuar torturë, përdhunim ose forma të tjera të dhunës psikologjike, psikike ose seksuale, siç janë viktimat e gjymtimit gjeneral femëror.




“Ku mund të më rivendosin?”

Në një nga këto shtete evropiane: Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Qipro, Çekia, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Hungaria, Irlanda, Letonia, Lituania, Luksemburg, Malta, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja ose Suedia.



“A mund të zgjedh shtetin në të cilin do të më rivendosin?”

Jo, s’ka mundësi të zgjidhni shtetin në të cilin do t’ju rivendosin. Megjithatë, kur të merret vendimi rreth shtetit të rivendosjes, autoritetet kompetente do të kenë parasysh, sa më shumë që të jetë e mundur, lidhjet tuaja familjare, aftësitë gjuhësore dhe ndonjë lidhje tjetër kulturore ose sociale që ju mund të keni me një nga shtetet që marrin pjesë në skemën e rivendosjes. Do të merren parasysh edhe faktorë të tjerë, siç janë numri i vendeve të disponueshme në çdo shtet dhe profilet e kandidatëve të tjerë për rivendosje.



“Si do të mësoj se në cilin shtet do të më rivendosin?”

Vendimi i rivendosjes do t’ju njoftohet me shkrim.

“Sa zgjat procesi?”

Në qoftë se përcaktohet që ju jeni i/e kualifikuar për rivendosje, transferimi do të kryhet sa më shpejt.

“Çfarë do të ndodhë pas marrjes së vendimit të rivendosjes?”

Ju do të merrni informacion lidhur me transferimin. Pas arritjes në shtetin e rivendosjes, autoritetet e tij do të përpunojnë aplikimin tuaj për mbrojtje ndërkombëtare. Ju nuk mund të shpërnguleni në një shtet tjetër në vitet e para të qëndrimit. Në qoftë se do të vendosni të shpërnguleni gjatë kësaj periudhe fillestare, do t’ju kthejnë në shtetin e rivendosjes.

